

Mund të sherohesh dhe pa përdorur antibiotikë

Antibiotikët – Duhet përdorini me kujdes,

Antibiotikët – përdorini vetëm nën rekomandimin e mjekut

Mbro veten, familjen dhe shoqërinë nga rezistenca ndaj antibiotikëve

Antibiotikët nuk janë gjithmonë zgjidhja. Shumë sëmundje shkaktohen nga bakteret ose viruset. Antibiotikët janë medikamente të rëndësishme që përdoren për mjekimin e infeksioneve bakteriale si në njerëz dhe në kafshë dhe **jo në infeksionet virale**. Antibiotikët po humbasin efektivitetin e tyre që do të thotë më shumë vdekje dhe më shumë komplikacione për njerëzit, pasi ne nuk po i përdorim ato siç duhet. Nëse bakteret bëhen rezistente ndaj antibiotikëve shumë mjekime të thjeshta do të bëhen përsëri të rrezikshme për shëndetin e tonë.

Viruset shkaktojnë sëmundje të zakonshme të cilat **NUK** mund të mjekohen me antibiotik si: gjendja gripale, kolla, rrjedhje hundësh, dhimbje fyti, bronkite, infeksionet e sinuseve, disa infeksione të veshit.

Marrja e antibiotikëve në rastin e sëmundjeve virale:

- NUK DO TJU SHËROJNË nga sëmundja që keni
- NUK DO TJU NDIHMOJNE që të ndiheni më mire
- NUK DO TI MBROJE të tjerët nga sëmundja juaj

MOS HARRONI – marrja e antibiotikëve sjell rreziqe të mundshme për shëndetin. Antibiotikët duhet të përdoren vetëm kur mjeku i rekomandon ato si të nevojshme për sëmundjen.

Përdorimi i antibiotikëve mund:

- Të vrasi bakteriet e mira që ndodhen në trupin e njeriut gjë e cila mund të çojë në komplikacione të tilla si diarre.
- Të shkaktojë reaksione alergjike serioze të cilat mund të kërkojnë shtrim në spital.
- Të rezultojë në infeksione rezistente ndaj antibiotikut. Bakteret rezistente janë të vështirë për tu eliminuar. Ato mund të qëndrojnë në trupin e njeriut dhe mund të shkaktojë sëmundje të rënda. Mjekimi për një infeksion rezistent mund të kërkojë një trajtim me antibiotikë më të fuqishëm (antibiotikë të gjeneratës së 2 ose 3) – ndoshta dhe shtrim në spital. Bisedoni me mjekun për mënyrën më të mirë të kujdesit për shëndetin tuaj gjatë kohës së sëmundjes.

Fakte të thjeshta rreth përdorimit të antibiotikëve

1. Antibiotikët janë medikamente të cilat shpëtojnë jetë

Përdorimi i antibiotikeve në mënyrën e duhur është mënyra më e mirë për të ruajtur efektivitetin e tyre për sëmundjet bakteriale.

2. **Antibiotikët trajtojnë vetëm infeksionet bakteriale.**

Nëse ju keni një infeksion viral si p.sh. një të ftohur ju duhet të bisedoni me mjekun për mënyrën se si të lehtësoni simptomat e sëmundjes. Këshillat mund të përfshijnë lëngje të ngrohta, pushim.

3. **Disa infeksione të veshit nuk kërkojnë përdorimin e antibiotikëve.**

Mjeku do të përcaktojë llojin e infeksionit të veshit që keni dhe nëse është i nevojshëm përdorimi i antibiotikëve. Mjeku mund të presë disa ditë përpara se të japë antibiotikun pasi ju mund të ndiheni apo bëheni më mirë edhe pa filluar antibiotikun.

4. **Pjesa më e madhe e rasteve me dhimbje fyti nuk kërkojnë trajtim me antibiotik.**

Vetëm 1 në 5 fëmijë të cilët janë vizituar nga mjeku për dhimbje fyti kanë infeksion të fytit të shkaktuar nga streptokoku, i cili duhet trajtuar me antibiotikë. Mjeku mund ta konfirmojë këtë infeksion vetëm me kryerjen e testit me material nga fyti.

5. **Mukusi me ngjyrë jeshile nuk është shenjë që duhet të fillojmë një antibiotik.**

Meqënëse sistemi imunitar i trupit lufton infeksionin, mukusi mund të ndryshojë ngjyrë. Kjo është një gjë mëse normale dhe ju nuk keni nevojë të merrni antibiotikë.

6. **Egzistojnë rreziqe të mundshme kur marrim antibiotikët që na përshkruan mjeku.**

Përdorimi i antibiotikëve mund të shkaktojë komplikacione, duke filluar nga një iritim të stomakut deri në reaksione alergjike serioze. Mjeku juaj duhet të vlerësojë përfitimet dhe rreziqet përpara se të përshkruajë një antibiotik.

Kryeni disa veprime të thjeshta:

- Mos kërkonit antibiotikë por trajtojini simptomat e gjendjes gripale dhe të kollës sipas këshillave të mjekut.
- Merrini antibiotikët siç përshkruhen nga mjeku
- Mos i ruani antibiotikët për ti përdorur në të ardhmen
- Mos i ndani antibiotikët me të tjerët

Mos harroni: E rëndësishme është që antibiotikët të përdoren në mënyrën e duhur, antibiotikun e duhur, në dozën e duhur, në kohën e duhur dhe për periudhën e duhur.